

Broshurë teknike

# ISOMAT AK-EPOXY FAST

## Ngjitës epoksid me mpiksje të shpejtë me 2 përbërës

### Përshkrimi

ISOMAT AK-EPOXY FAST është një ngjitës epoksid me mpiksje të shpejtë me 2 përbërës dhe pa tretës. Ka një rezistencë të lartë në shtypje, në përkulje dhe në prerje të lidhjes së ngjitëses. Është rezistent ndaj disa acideve, bazave, agjentëve gërryes për betonin, agjentëve pastrues, ujit të detit dhe ujit të kripur. Është i lehtë për t'u përdorur për shkak të raportit të thjeshtë të përzierjes së dy përbërësve (A:B = 1:1 sipas vëllimit).

### Fushat e përdorimit

ISOMAT AK-EPOXY FAST është i përshtatshëm për ngjitjen e mermerëve, granteve dhe shumicën e materialeve të ndërtimit mbi shtresa të ndryshme (beton, dru, metal etj.), mbi mure ose dysheme. Është ideal për ngjitjen në sipërfaqe vertikale për arsye të mpiksjes të shpejtë (7 minuta). Përshtatet për përdorim në mjedise të brendshme ose të jashtme.

### Të dhënat teknike

Baza:	rrëshirë epokside me 2 përbërës
Ngjyra:	gri-e gjelbër
Raporti i përzierjes:	1:1 sipas vëllimit
Rezistenca në shtypje:	60 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca në përkulje:	15 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca në prerje e ngjitjes:	> 9 N/mm <sup>2</sup>
Temperatura minimale e mpiksjes:	+5°C
Koha e punueshmërisë:	3 minuta në +25°C
Koha minimale e tharjes:	1 orë në +25°C
Koha e plotë e tharjes:	24 orë në +25°C
Pastrimi i veglave:	
Veglat duhet të pastrohen menjëherë pas përdorimit me tretësin SM-25.	

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Nënshtrësja

Sipërfaqja duhet të jetë e thatë, e pastër, e qëndrueshme, pak e ashpër dhe pa materiale që pengojnë ngjitjen, si p.sh. pluhuri, grimcat e lira, mbetjet e vajit etj.

#### 2. Përzierja e përbërësve

Përbërësit A (rrëshira) dhe B (forcuesi) janë të paketuara në dy enë të ndara, me raport të paracaktuar të përzierjes. Secila sasi, sipas vëllimit, nga përbërësi A dhe përbërësi B hidhen në një enë të pastër dhe përzihen për rreth 5 minuta duke përdorur një vegël pune të përshtatshme (p.sh. mistri e vogël), derisa të krijohet një stuko uniforme në trajtë brumi.

#### 3. Përdorimi

Rekomandohet që përpara përdorimit sipërfaqja e mermerit ose e granitit të ashpërsohet duke përdorur një vegël me disk gërryes. ISOMAT AK-EPOXY FAST aplikohet me mistri mbi sipërfaqen e ashpërsuar dhe pastaj mermeri ose graniti ngjiten duke i ngjeshur në pozicionin e dëshiruar.

### Konsumi

Konsumi varet nga përmasat dhe pesha e materialit që do të ngjitet. Në sipërfaqe vertikale, nëse mermeri/graniti nuk do të shtrëngohen mekanikisht, ngjitësja duhet të aplikohet të paktën në 10% të sipërfaqes.


### Amballazhimi

ISOMAT AK-EPOXY FAST ofrohet në pako (A+B) me 20 litër, 4 litër dhe 1 litër, me përbërësit A dhe B, të cilët kanë raporte fikse të paracaktuara të vëllimit.

# ISOMAT AK-EPOXY FAST

## Magazinimi

Të paktën 24 muaj nga data e prodhimit nëse ruhet në paketimin origjinal të izoluar, në ambiente të mbrojtura nga lagështira dhe ekspozimi në dritën e diellit. Rekomandohet një temperaturë ruajtjeje midis +5°C dhe +35°C.

	
<b>ISOMAT S.A.</b> 17 <sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece 09	
<b>EN 12004:2007+A1:2012</b> <b>DoP No.: ISOMAT AK-EPOXY FAST/1089-02</b> <b>NB: 2032</b> Improved, reaction resin adhesive, with reduced slip, for internal and external tiling.	
<b>Reaction to fire</b>	Class F
<b>Release of dangerous substances</b>	See MSDS
<b>Bond strength, as:</b>	
- initial shear adhesion strength	≥ 2 N/mm <sup>2</sup>
<b>Durability, of</b>	
- shear adhesion strength after thermal shock	≥ 2 N/mm <sup>2</sup>
shear adhesion strength after water immersion	≥ 2 N/mm <sup>2</sup>

**ISOMAT S.A.**  
BUILDING CHEMICALS AND MORTARS  
**ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:**  
17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,  
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475  
**www.isomat.al e-mail: info@isomat.eu**